

**Akt themelimi  
I shoqërise me përgjegjësi të kufizuar  
" SHTËMBARI " shpk**

Ne bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 'Për qendrën kombëtare të biznesit ' sot më datë 10/09/2023, ne të nënshkruarit:

- 1-Elton Shtëmbari,shtetas Shqiptar , i biri i Kozma, lindur më 27/04/1986 në Gorre dhe banues në Bishqethëm , mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034415443, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i parë** ») ; dhe
- 2- Mario Shtëmbari, shtetas Shqiptar ,i biri i Kozma , lindur më 21/06/1981 në Lushnje dhe banues në Bishqethëm, mbajtës i letërnjoftimit me nr.033144403 , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i dyte** »)

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi,dhe në kushtet e përcaktuara në Statut.

Aktiviteti I kesaj shoqerie do te rregullohet nga statuti I saj, I cili eshte pjese perberese e ketij akti themelimi dhe I bashkangjitet si shtoja 1.

**Neni 1**

**Emri I shoqerise eshte " SHTËMBARI" shpk**

**Neni 2**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën :

Lushnje, Njesia administrative Kolonje, Bishqethëm, godina me Nr.Pasurie 54/5 ne Z.Kadastrale 1197.

Shoqëria mund të krijojë degë,zyrë,filiale dhe të zhvilloj aktivitet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të ortakëve të Shoqërisë.

### Neni 3

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar të Republikës së Shqipërisë. Prishja dhe likujdimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asambleës së përgjithshme të ortakëve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

### Neni 4

Objekti I shoqërise është si më poshtë:

Ndërtime banesa dhe rikonstruksione të ndryshme baneshash, pallate dhe hotele. Karpentier.Përpunim dhe lidhje hekuri . Suvatime te brendshme dhe të jashtme. Lyerje të brendshme dhe të jashtme , shtrirë plakash, mermer dhe parkete . Punime çatie me tjegulla dhe druri , punime elektrike dhe hidrualike .Punime murature , gërmime dheu , hedhje betoni , hidroizolime . Dekore fasadash dhe veshje të ndryshme fasadash. Punime duroalumini. Punime të ndryshme ndërtimi.Ndërtime struktura parafabrikate prej betonarme, druri dhe metalike. Gërmim dheu, pilota, diafragma, ankorime, mure mbajtëse, stabilizim skrapate dhe përforcim dhera.Punime per prishjen e ndërtimeve. Transport kombëtar dhe ndërkontrollor të mallrave me mjetet e vetë shoqërisë, për llogari të saj, të të tretëve dhe me qera. Transport të mallrave me mjete jashtë norme dhe shoqërim teknik të tyre. Import-export dhe tregëtim me shumicë dhe/ose pakicë te pajisjeve dhe materialeve te ndërtimit, industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, elektroshtepiake, hidraulike, elektrike, elektronike, drusore, pjesë këmbimi të reja dhe përdorura, brenda dhe jashtë vendit.

### Neni 5

Kapitali themeltar I shoqërisë është 20.000.000 lekë (njëzet milion) lekë, I cili ndahet në 2 kuota,të cilat zotërohen nga ortakët e saj.Kapitali themeltar është i nënshkruar nga ortakët.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te te gjithe ortakeve.

Ortakët e Shoqërisë janë si vijon :

- a) Elton Shtëmbari,shtetas Shqiptar , i biri i Kozma, lindur më 27/04/1986 në Gorre dhe banues në Bishqethëm , mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034415443, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « ortaku i parë »)

Ortaku i parë zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 10.000.000 lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtës së votës në asamblenë e përgjithëshme të ortakëve sipas këtij statuti.

b) Mario Shtëmbari, shtetas Shqiptar ,i biri i Kozma , lindur më 21/06/1981 në Lushnje dhe banues në Bishqethëm, mbajtës i letërnjoftimit me nr.033144403 , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i dyte** ») Ortaku i dytë zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 10.000.000 lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtës së votës në asamblenë e përgjithëshme të ortakëve sipas këtij statuti.

### Neni 6

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet vendimeve të ortakëve të shoqërisë. Administrator i Shoqërisë do të jetë: Mario Shtëmbari, shtetas Shqiptar ,i biri i Kozma , lindur më 21/06/1981 në Lushnje dhe banues në Bishqethëm, mbajtës i letërnjoftimit me nr.033144403, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar- i cili do të emërohet për një mandat fillestare 5 (pesë) vjeçar me të drejtë ri-emërimi. Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm të shoqërise dhe mund të kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.

### Neni 7

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë I besohet një eksperti kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq kohë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shpërblimin përkatës ,kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

### Neni 8

Cështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë akt themelimi, do ti referohen ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" I ndryshuar, si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

### **Neni 9**

Akti i themelimit është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë.

### **ORTAKET**

**Elton Shtëmbari**



**Mario Shtëmbari**

